



C.nr.146/2013

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, duke vendosur në lëndën kontestimore të paditësit, Komuna e [REDACTED], të cilin sipas autorizimit e përfaqëson [REDACTED], kundër të paditurit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED], baza e kontestit borgj, e pas mbajtjes së seancës kryesore më dt.28.04.2016 mori këtë :

A K T G J Y K I M


I-REFUZOHEM SI E PABAZUAR kërkespadija e paditëses Komuna e [REDACTED], me të cilën ka kërkuar që **DETYROHET** i padituri [REDACTED] që paditëses Komuna e [REDACTED] në emër të borxhit të ia paguaj shumën e të hollave prej 5200 € me kamatë të cilën bankat e paguajnë për mjetet e deponuara monetare në afat një vjeçar pa destinim të caktuar

II. Detyrohet paditësja Komuna e [REDACTED] që kësaj gjykate në emër të taksës gjyqësore për aktgjykimi t'ia paguaj shumën e të hollave prej 50 euro.

A r s y e t i m

Paditësja Komuna e [REDACTED] ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED], Komuna e [REDACTED], me bazë juridike pagesa e borgjit nga kontrata mbi qiran.

Paditësja në padi ka theksuar :Paditësi dhe i padituri kanë lidhur kontratën e qiras nr.1991, të dates 09.05.2003, për periudhën kohore prej 01.05.2003 deri më 01.05.2004, sipas së cilës paditësja i'a ka dhënë me qira lokal in afarist dhe fushën e futbollit të vogël, që gjindet në stadionin e qytetit "[REDACTED]", kurse i padituri i ka marrë paluejtshmërit e përmendura me qëllim që në lokal in afarist të ushtrij veprimtari hoteljere, kurse në fushën e futbollit të vogël ka ngrehë një fushë sportive të mbuluar dhe është obliguar që për shfrytëzimin e këtyre hapsirave t'ia paguajë paditëses qiranë për qdo muaj në shumën prej 400 euro. Paditësja me të paditurin kanë lidhur kontratën e qirasë nr.5083 të dates 24.09.2004, me të njejtat kushte sikur kontrata paraprake për periudhën kohore prej 01.05.2004, deri më 31.01.2005, me mundësi vazhdimi. Meqenëse pas kalimit të kohës për të cilën është lidhur kontrata nr.5083, e dates 24.08.2004, pra pas datës 31.12.2005, i padituri si qiramarrës, ka vazhduar ta shfrytëzoj dhe është duke i shfrytëzue edhe tani paluejtshmërit, të cilat kanë qenë objekt i kontratës së qiras ndërsa paditësja si qiradhënës, nuk ka kundërshtuar, atëher konform nenit 596 al 1 të Ligjit mbi Mardhënjet Obligative, konsiderohet se është lidhur kontrata e re e qiras me kohëzgjatje të pacaktuar, në të njejtat kushte sikurse edhe kontrata paraprake, i padituri deri me datën 31.01.2012, i ka mbetur borgj paditëses në shumë prej 22000, në emër të qiras së papaguar. Paditësja me kërkespadi fillimishtë ka kërkuar nga gjykata që të



obligohet i padituri ,që t'ia paguaj paditëses shumën prej 22000,me kamatë ligjore ,sikurse për mjetet e deponuara ,pa destinim të caktuar që paguan banka ,duke filluar nga dita e ngritjes së padis ,e deri në pgesën definitive.Kurse në seancën e dates 11.03.2016 përfaqësuesi i autorizuar i paditëses ka bërë precizimin e kërkesëpadis gjegjësishtë zvogëlimin e sajë dhe ka kërkuar nga gjykata ta detyroj të paditurin [REDACTED] që paditëses Komuna e [REDACTED] në emër të borxhit të ia paguaj shumën e të hollave prej 5200 € me kamatë të cilën bankat e paguajnë për mjetet e deponuara monetare në afat një vjeçar pa destinim të caktuar,si dhe ka deklaruar se nuk kërkoj shpenzimet e procedurës.

I Padituri [REDACTED] ka theksuar se e kundërshtoj padinë dhe provat të cilat më ngarkojnë me borxh dhe propozoj gjykatës që ta refuzoj për shkak se nuk i kam borxh paditëses dhe borxhi është parashkruar, dhe objektet për të cilat kërkohet qiraja nuk i kam shfrytëzuar prej vitit 2006 e deri në ditën e sotme. Për konkluzione edhe një herë e njoftoj gjykatën se nuk di asgjë, sepse kurrë nuk më janë dorëzuar, dhe thënjët e atyre konkluzioneve nuk janë të vërteta.

Gjat shqyrtimit kryesorë janë administruara si provë:kontrata mbi qiranë që i referohet periudhës kohore 01.05.2003 deri më 01.05.2004,kontrata që i referohet periudhës kohore 01.05.2004 deri më dt:31.05.2005,shkresa ku shkruan Analitika qiramarrësit me gjendje e dt:31.01.2010,njoftimi i lëshuar më dt:01.03.2016 nga Drejtoria për financa,aktvendimi i datës 20.11.2012 mbi tërheqjen e padisë,padia e dt:15.02.2010,konkluzi e dt:15.04.2010,dhe 01.03.2007 si dhe deklarata,aktvendimi i dt:22.12.2006 dhe shkresa e dt:31.12.2007.

Gjykata pasi analizoi provat e administruara ,thënjët e palëve ndërgjyqëse vendosi ashtu siq është shkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi edhe atë nga këto arsye :nga thënjët e paditëses në padi ,si dhe provat materjale të prezantuara nga paditësja ,si kontrata që i referohet periudhës kohore 01.05.2004 deri më dt:31.05.2005 ,njoftimi ,i datës 01.03.2016,i lëshuar nga Komuna e Ferizajit gjykata ka vlerësuar ,se paditësja nga i padituri kërkon një borgj ,i cili sipas paditëses ka arritur për pagesë në periudhën kohore viti 2009 ,deri më 05 Shkurt të vitit 2010,nga vula e pranimit të padis e cila është objekt shqyrtimi ,sipas kësaj lënde ,rezulton se paditësja padin në fjalë për pagimin e borgjit në vlerë prej 5200 e ka paraqitur me datë 27.02.2013 ,pra nga gjendja faktike e sipër përmendur rezulton se paditësja padin e saj e cila është objekt shqyrtimi ,me të cilën kërkon pagesën e borgjit ,e ka paraqitur në gjykatë pas kalimit të afatit 3 vjeçar ,duke llogaritur nga momenti kur sipas paditëses i padituri ka pasur detyrim t'ia paguaj borgjin i cili është objekt i padis së paditëses ,kjo edhe për shkak se edhe nga data 05 Shkurt 2010 ,deri me datën 05 Shkurt 2013 bëjnë tre vite ,kurse paditësja padin e ka paraqitur me 27.02.2013 ,pra pas kalimit të afatit tre vjeçar të sipër përmendur .Meqë ka kaluar afati i sipër përmendur 3 vjeçar ka ardhur deri te parashkrimi i kërkesëpadis së paditëses edhe atë në bazë të neneve 375,372 të LMD-së,dhe nenit 353 dhe 356 të LMD-së,i ri.

Gjykata analizoi edhe padin e paditëses ,e cila rezulton të jetë dorëzuar në gjykatë 15.02.2010,mirëpo gjykata konsideron se e njejta padi, në kuptim të dispozitës së nenit 389 të LMD-së së vjetër nuk ka pasur efekt në ndërprerjen e parashkrimit,sepse e njejta padi ,me aktvendimin C.nr.47/2010,i datës 20.11.2012[i cili gjindet në shkresat e lëndës] është

konsideruar e tërhequr .Me dispozitën e nenit 389 të LMD-së është paraparë Ndërprerja e parashkrimit e bërë me ngritjen e padisë ose me ndonjë veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimin të kërkesës, konsiderohet se nuk ka filluar po qe se kreditori heq dorë nga padia ose veprimi që ka ndërmarrë.



Ligji Procedurës kontestimore ,ka caktuar veprimet ose mos veprimet e palës paditëse të cilat kanë efektin e tërheqjes së padisë ,e që tërheqja padisë dhe heqja dorë nga padia kanë kuptim të njëjtë në aspektin e pasojave juridike.Nga kuptimi i dispozitës së nenit 409 të LPK-së rezulton se është paraparë se mosveprimi i paditësit ,gjegjësishtë mos shkuarja e tij në sancë edhe pse është thirrur rregullisht ,konsiderohet si akt që ka për pasojë tërheqjen e padisë.Nga përmbajtja e aktvendimit të datës 20.11.2012,nr.C.nr.47/2010 rezulton se i njëjti aktvendim është bazuar në dispozitën e nenit 409 të LPK-së.

Gjykata e ka detyruar paditësin që kësaj gjykate t'ia paguaj taksën gjyqësore për aktgjykimin,duke u bazuar në udhëzimin administrativ për Unifikimin e taksave gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Më datë 28.04.2016



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KO



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JË PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC.



02 06 2016

Republika e Kosovës Republika Kosovo



SAKTËSI E KOPJËS E VËRTETON
TAKSA PLOTËSI
TAKSA POTVRDIJE



autorizuar
raçnik